# DËSHMI ARKIVI

**A-477675**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kaja Kallas: Tallja e Rusisë me takimin në OKB tregon se s’i intereson t’i japë fund luftës në Ukrainë |
| ADRESA | `https://dosja.al/bota/kallas-tallja-e-rusise-me-takimin-ne-okb-tregon-se-si-intereson-ti-jape-fun-i516596` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 20:34:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 20:27:13 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `60bb4ac3ee1bdc70c30c8210f4912f1fe5fb34cbe7a96cb876e697cd1fe864b3` |
| TEKSTI | `44056aef46b09b54bc8285df4dd97df783099c9c06594c17a289289496d9d24c` |
| PAMJA | `5b552684fee4c7aaa4a94d659c8310e01779a288a09cd0a694327a868069de86` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `83016b5628bd669cf1a563be3cc493fed19bd2c6c8537ed3343ecfff31a63d75` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `81d9502dee89498020984867f5c9e7803768541a0034d6fb041c0efcf168cb37` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/83016b5628bd669cf1a563be3cc493fed19bd2c6c8537ed3343ecfff31a63d75`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

2 ORE ME PARE
**121 ditë revoltë kundër Edi Ramës/ Protestuesit masazh kryeministrit me pankarta: Asgjë s'të ndal për të vjedhur, por SPAK-u ka për ta mbledhur**

2 ORE ME PARE
**Debate për territorialen te "Ligjet"/ Rrëzohet kërkesa e opozitës për futjen e draftit të saj në rend dite! Manja: Nuk e kam në tryezë, duhet të ndjekë procedurën**

8 ORE ME PARE
**Pagat e magjistratëve/ GJL dhe shoqatat e gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë punën për ligjin e pagave**

10 ORE ME PARE
**Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder tregon detyrat: Kapitujt duhen mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në baltë, do jetë dështim**

Bota

# Kaja Kallas: Tallja e Rusisë me takimin në OKB tregon se s'i intereson t'i japë fund luftës në Ukrainë

Takimi i 26 shtatorit mes Lavrovit dhe Wadephulit u zhvillua në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork dhe ishte takimi i parë mes ministrave të Jashtëm të Gjermanisë dhe Rusisë që nga fillimi i pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Moska, në fillim të vitit 2022.

dosja
28 Shtator 2026, 22:27
**Nga E. D**



Sergei Lavrov dhe Johann Wadephul

**BRUKSEL-** Shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, tha të hënën se mënyra se si ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergei Lavrov, u soll me homologun e vet gjerman, Johann Wadephul, pas takimit të tyre rishtazi në OKB, tregon se Rusia nuk është e interesuar për paqe në Ukrainë.

Takimi i 26 shtatorit mes Lavrovit dhe Wadephulit u zhvillua në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork dhe ishte takimi i parë mes ministrave të Jashtëm të Gjermanisë dhe Rusisë që nga fillimi i pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Moska, në fillim të vitit 2022.

Si në fjalimin e tij në Kombet e Bashkuara më vonë atë ditë, ashtu edhe në një konferencë pasuese për media, Lavrovi u tall me takimin me Wadephulin dhe hodhi poshtë thirrjet e Gjermanisë për ndalimin e sulmeve ndaj Ukrainës, të cilat ditët e fundit kanë shkaktuar viktima të shumta në mesin e civilëve.

*"Ka shumë vende jashtë Evropës që thonë: 'Flisni me rusët dhe pastaj do të ketë rezultat (në Ukrainë)'. Por kjo bisedë [mes Wadephulit dhe Lavrovit] tregon se Rusia me të vërtetë nuk është aspak e interesuar për paqe. Përndryshe, nuk sillet në këtë mënyrë me bashkëbiseduesin e vet"*, tha Kallas, duke iu referuar sjelljes së Lavrovit.

Kallas tha se gjatë takimit Wadephuli kishte ngritur nevojën për shtensionimin e luftës në Ukrainë, si dhe sulmet hibride në Evropë. Në fillim të shtatorit, Berlini e fajësoi Rusinë për incidente me dronë që në gusht shkaktuan ndërprerjen e trafikut në aeroportin e Lajpcigut.

Duke i hedhur poshtë thirrjet për shtensionim, Lavrovi këmbënguli se luftimet do të vazhdojnë deri në fund. Ai e akuzoi Berlinin se është mbështetësi kryesor i Ukrainës dhe se po përpiqet të bëhet sërish fuqi ushtarake udhëheqëse në Evropë.

editoriale

Meri Lika
Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj
Labirinti i errët i Edi Ramës

Në vëmendje

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 21:38
VIDEO/ As Ulsi Manja nuk u shpëton protestuesve, aktivistja e 'pret" tek dera e Kuvendit: O hajdut

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 16:51
Reforma territoriale/ Këshilli Bashkiak i Belshit voton kundër bashkimit me Elbasanin, socialistët abstenojnë

*"A e kupton Berlini se ku mund të çojë kjo?*", pyeti ai në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, duke shtuar: "A *nuk i kanë mësuar ata mësimet e Luftës së Dytë Botërore?"*

Ai tha gjithashtu se Moska do të vendoste veto ndaj çdo përpjekjeje të Gjermanisë për të siguruar një ulëse të përhershme në Këshill të Sigurimit të OKB-së, nëse ky institucion, organi më i fuqishëm i Kombeve të Bashkuara, do të zgjerohej.

johann wadephul sergei lavrov

## Sondazh

Poll

Bota

28 Shtator 2026, 21:56

# "Kujdes"! Alarm për WhatsApp-in, AKSK paralajmëron për kompromentim llogarish dhe apelon për kujdes të shtuar

WhatsApp RAJON- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike u ka bërë thirrje qytetarëve të tregojnë kujdes të...

### Grabitje spektakolare përmes AI/ Mashtruesit marrin rreth 100 milionë euro nga Intesa Sanpaolo

Bota

28 Shtator 2026, 20:17

### Analiza: Çfarë i karakterizoi 14 vitet e Vuçiç në pushtet?

Bota

28 Shtator 2026, 20:10

### "Moska po përpiqet të krijojë pasiguri"/ Komandanti i NATO-s: Rusia synon të dobësojë vullnetin e aleatëve për të mbështetur Ukrainën

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 13:36

### VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

## më të klikuarat

Hakerat iranianë nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Laert Haxhia i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, kërkon rigjykim të çështjes: Më janë shkelur të drejtat

## insights

Bledian Koka

Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

## Moti

Powered by tomorrow.io

Bota

28 Shtator 2026, 19:45

---

### Pas bisedës Vuçiç-Putin, Departamenti i Shtetit rikujton deklaratën e Rubios për çështjet problematike

Bota

28 Shtator 2026, 17:57

---

Bota

28 Shtator 2026, 17:55

## Kongresistë republikanë kërkojnë të mos i zgjatet licenca Industrisë së Naftës së Serbisë

Kongresisti republikan, Joe Wilson. Fotografi nga arkivi. Dy republikanë në Dhomën e Përfaqësuesve të Shteteve të Bashku...

---

### Kërkoi masa kundër Ebolës, politikani në Kongo rrihet për vdekje dhe i digjet shtëpia

Bota

28 Shtator 2026, 17:20

---

### Komediani turk dënohet me 19 muaj burg për fyerje ndaj Erdoganit, përdori termin 'diktator' në një shfaqje humoristike

Bota

28 Shtator 2026, 17:03

---

### “Mund të rrëzojmë çdo qeveri që duam”/ Deklarata e ambasadores amerikane shkakton polemika në Athinë, opozita kërkon shpjegime

Bota

28 Shtator 2026, 16:17

---

### Ukraina raporton bombardime

vdekjeprurëse ruse në Kiev, Harkiv dhe Dnjepër

Bota

28 Shtator 2026, 16:12

## MË SHUMË





Me flakadanë në duar, protestuesit marshojnë nëpër rrugët e Tiranës, thirrje njëzëri kundër qeverisë


Dita e 121-të e protestës, qytetarët marshojnë drejt Kryeministrisë


Zjarr pranë banesave në Gjirokastër, zjarrfikësit ndërhyjnë për shuarjen e flakëve


Vatër zjarri në Kreshpan të Fierit, kërkohet ndërhyrja nga ajri

Me flakadanë në duar, protestuesit marshojnë nëpër rrugët e Tiranës, thirrje njëzëri kundër qeverisë

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]

AKTUALITET
POLITIKE
EKONOMI
BOTA
SPORT
ART&ARGËTIM
INSIGHTS
EDITORIAL

Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDESUAR NGA Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.